



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 66/5 prot.

Tiranë, më 14.2.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Robert Kote
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese;

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.1.2023, është njoftuar vendimi nr. 600, datë 19.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Robert Kote, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Robert Kote, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Robert Kote, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e

të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

1.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të: “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Robert Kote*”,<sup>1</sup> ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit fillestar<sup>2</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Robert Kote, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Robert \*\*\* Kote*”. Pas kërkesës së Komisionit për përditësimin e raportit, DSIK ka përcjellë raportin<sup>3</sup> e rishikuar, në të cilin shprehet se: [...] *Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Robert Kote, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit[...].*

1.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore, të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin<sup>4</sup> për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Robert Kote.

**2.** Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

2.1 **Për vlerësimin e pasurisë**<sup>5</sup> [...] bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultojnë të jetë e ligjshme. Trupi gjykues vlerëson se nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit [...].

<sup>1</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2018.

<sup>2</sup> Shkresa e DSIK-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017.

<sup>3</sup> Shkresa e DSIK-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2022, të KDZH-së.

<sup>4</sup> Shkresa e KLP-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2022.

<sup>5</sup> Shihni f. 15 të vendimit, pikat 23 dhe 23.1.

[...] Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se, pavarësisht pasaktësive në deklarin e tij, subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues dhe ka informuar Komisionin lidhur me çdo kërkesë gjatë hetimit administrativ. Pasuria e vetme e subjektit të rivlerësimit është një apartament, krijuar në vitin 1999, me burim të ardhura nga kredia bankare. Nga hetimi ka rezultuar se ai ka shpenzime dhe stil jetese modest dhe se situata negative financiare prej -521.409 (pesëqind e njëzet e një mijë e katërqind e nëntë) lekësh, për vitin 2014 – 2015, nuk duhet të përbëjë shkak për aplikimin e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 [...].

**3. Për kontrollin e figurës<sup>6</sup>** [...] Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Robert Kote ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...].

**4. Për vlerësimin e aftësive profesionale<sup>7</sup>** [...]Subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë dhe është efektiv në punën e tij. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues, të kërkuar nga neni 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e aftësive profesionale [...].

**5. Për vlerësimin tërësor<sup>8</sup>**, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 [...] problematikat e konstatuara gjatë vlerësimit të procedimit penal nr. \*\*\*/2016, nga prokurori Robert Kote, si dhe kontaktin e tij me shtetasin \*\*\*,\*\*\*, Komisioni ... çmon se veprimet e subjektit të rivlerësimit në mënyrën e interpretimit të çështjes në procedimin penal nr. \*\*\*/2016 kanë një logjikë në interpretimin e tyre lidhur me vetë problematikën e konstatuar në ndryshimet/interpretimin e nenit 278 të Kodit Penal dhe se qëndrimi i tij, gjithashtu, ka qenë në një linjë me qëndrimin e policisë gjyqësore që ka referuar veprën, e cila kishte bërë kapjen në flagrancë të autorëve. Pavarësisht se trupi gjykues çmon se qëndrimi i prokurorit vjen si pasojë e një hetimi të pathelluar dhe i një vlerësimi sipërfaqësor të fakteve që kanë rezultuar nga provat e administruara, duke vlerësuar se është bërë një zbatim i gabuar i dispozitës materiale për çështjen konkrete në gjykim, çmon gjithashtu se ky vlerësim ka të bëjë me thelbin e zgjidhjes së çështjes dhe bindjen e prokurorit, ndaj nuk duhet të gjykohet e vlerësohet nga ky trup gjykues në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Trupi gjykues çmon se shkelja e kryer në rrethanat e lartpërmendura na çon në konkluzionin se ajo nuk mund të konsiderohet si shkelje haptazi dhe në kundërshtim flagrant me ligjin dhe, për pasojë, të kualifikohen si shkelje të rënda profesionale. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se vetëm zgjidhja e kësaj çështjeje në këtë mënyrë, e vlerësuar në tërësinë e saj, në raport edhe me aktivitetin shumë të gjatë në sistem të këtij prokurori, nuk mund të konsiderohet se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në vlerësim të kontaktit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin \*\*\*,\*\*\*, trupi gjykues nuk gjen elemente apo rrethana për ta konstatuar këtë shtetas një person të përfshirë në krimin e organizuar, as marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas të tillë që cenon standardin e besueshmërisë së një prokurori. Në këtë konkluzion, trupi gjykues

<sup>6</sup> Shihni f.19 të vendimit, pika 28.

<sup>7</sup> Shihni f. 24 të vendimit, pika 37.

<sup>8</sup> Shihni f. 24 të vendimit, pika 38.

*ka arritur duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimet e konsoliduara nga jurisprudenca sipas të cilave, shkelja e rëndë etike, sipas përcaktimeve kushtetuese, duhet të jetë e një niveli që e bën prokurorin të padenjë për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë [...].*

**6. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, bazuar në pikën 5 të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, Trupi gjykues, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, *me shumicë votash*<sup>9</sup>, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Robert Kote.*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**7.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**8.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që iu njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**9.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**10.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 600/2022, të Komisionit, dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, pasi përfundimet e arritura nga Komisioni duket se nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.

**11.** Për këto arsye, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

### **III. A. Kontrolli i pasurisë**

**12.** Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë

---

<sup>9</sup> Ka votuar kundër konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, kryesuesi i trupës gjyquese, z. \*\*\*.\*\*\*.

se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**13.** Po ashtu, Komisioneri Publik mban në konsideratë dhe jurisprudencën e konsoliduar tashmë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili shqyrton çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit.

**14.** Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të janë deklaruar fillimisht në: “*Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie*”, dorëzuar në ILDKPKI, në datën \*\*.3.2004, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën \*\*.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet se:

**15. Pasuria “autoveturë” me targë: \*\*\*, marka Audi A4**

15.1 Në DV-2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Autoveturë e tipit Audi A4, me targa: \*\*\*, e blerë në shumën 1.000.000 lekë, me faturë blerje nr. \*\*\*, dt. \*\*.8.2015, nga \*\*\*. Burimi i krijimit: Shitja e automjetit të mëparshëm e tipit Rover 75, me kontratën nr.\*\*\* rep., në shumën 4.000 euro dhe nga kursimet. Pjesa takuese nuk deklarohet.*

15.2 Referuar akteve në dosje konstatohet se: (i) DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin tip “Audi A4”, me targa: \*\*\*, regjistruar në pronësi të tij në datën \*\*.9.2014; (ii) me Kontratë shitje datë \*\*.8.2014, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i shet subjektit të rivlerësimit automjetin tip “Audi A4”, kundrejt vlerës 1.000.000 lekë, shoqëruar me faturë tatimore shitjeje nr. \*\*\*, datë \*\*.8.2014; (iii) me Kontratë shitje nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2016, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës shitëse, ia ka shitur automjetin tip “Audi A4”, me targë: \*\*\* shtetasit \*\*\*.\*\*\*, kundrejt vlerës 6.000 euro.

15.3 Lidhur me të ardhurat nga shitja e autoveturës e markës Rover, që deklarohen si burim krijimi për autoveturën me targë: \*\*\*, rezulton se, me Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.1.2012, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Rover” nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, kundrejt çmimit 1.000 euro dhe ka kryer shpenzime zhdoganimit në vlerën 36.121 lekë. Ky automjet është shitur me Kontratën e shitjes me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.8.2014, shtetasit \*\*\*.\*\*\*, kundrejt shumës 4.000 euro.

15.4 Komisioni ka konstatuar se, bazuar në germën “b”, të pikës 5, të nenit 22, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, amortizimi i aktiveve të tjera të veprimtarisë, ku përfshihen edhe automjetet, është 20% në vit. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht përdorimit për rreth 3 vjet të automjetit, çmimi i shitjes 4.000 euro, është disa herë më i shtrenjtë se çmimi i blerjes,

duke ngritur dyshime për çmim fiktiv dhe, si rezultat, në analizën financiare të vitit 2014, nuk është konsideruar shuma 4.000 euro si e ardhur<sup>10</sup>.

15.5 Komisioni ka kryer analizën financiare deri në datën \*\*.8.2014, data e blerjes së autoveturës marka “Audi A4”, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për mbulimin me burime të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie në shumën -783.737 lekë<sup>11</sup> dhe, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës për rezultatin negativ financiar.

15.6 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet përfundimtare lidhur me shitjen e pasurisë *autoveturë*, me targë: \*\*\*, marka “Rover”, në shumën 4.000 euro, ka deklaruar se çmimi i vendosur në kontratë është çmimi i vërtetë i arkëtuar prej tij, si dhe ka deklaruar se nuk ka shtuar pasuri apo të ketë përballuar ndonjë shpenzim, që do t'i duhej të justifikonte këto shuma duke rritur të ardhurat<sup>12</sup>.

15.7 Në lidhje me pamundësinë financiare në shumën -783.737 lekë, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pretenduar që Komisioni të konsiderojë si të ardhur shumën 4.000 euro nga shitja e automjetit “Rover”, të vlerësojë argumentet për kursimet *cash* të poseduara nga bashkëshortja ndër vite.

15.8 Komisioni i ka gjetur të vërteta e të besueshme deklaratimet e subjektit se: [...] *Nuk kam pasur asnjë nevojë apo arsye të vendos një çmim joreal për të justifikuar në rritje të ardhurat e familjes, nuk kam shtuar pasuri apo të kem përballuar ndonjë shpenzim, që do më duhej të justifikoj nga ana tjetër këto shuma në rritje të të ardhurave [...]*<sup>13</sup>.

15.9 Komisioni, për pasurinë *autoveturë*, me targë: \*\*\*, arrin në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e pasurisë automjet tip Audi A4, në shumën -783.737 lekë, në vitin 2014. Kjo situatë është reflektuar në analizën financiare të subjektit [...]*.<sup>14</sup>

15.10 Komisioneri Publik, referuar akteve të administruara në dosje, vëren se, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e saj, lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni, për mbulimin me burime të ligjshme të krijimit të pasurisë *autoveturë*, me targë: \*\*\*, marka *Audi A4*, në shumën -783.737 lekë.

15.11 Gjithashtu ndajmë qëndrim të ndryshëm me përfundimin e Komisionit, cituar sa më lartë, në pikën 15.8., pasi sikundër deklaroi subjekti i rivlerësimit, të ardhurat nga shitja e pasurisë *autoveturë* me targë: \*\*\*, marka *Rover*, kanë shërbyer për blerjen e pasurisë *autoveturë* me targë: \*\*\*.

15.12 Në përfundim, për pasurinë *autoveturë*, me targë: \*\*\*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në shumën -783.737 lekë, si dhe duket se

---

<sup>10</sup> Referohuni aktit “Rezultate të hetimit administrativ”, f. 4. Në analizën financiare rezulton të jetë përfshirë si e ardhur nga shitja e këtij automjeti, shuma 176.235 lekë, që duket se korrespondon me vlerën e blerjes.

<sup>11</sup> Referohuni aktit “Rezultate të hetimit administrativ”, f. 4 dhe f.11.

<sup>12</sup> Referohuni dokumentit me emërtim “Observacion i prokurorit Robert Kote, për të vërtetuar të kundërtën dhe në përgjigje të barrës së provës”, f. 3.

<sup>13</sup> Shihni f. 6, pika 16.7 e vendimit.

<sup>14</sup> Shihni f. 6, pika 17.4 e vendimit.

ka kryer veprim fiktiv, duke përcaktuar një çmim disa herë më të lartë në shitjen e pasurisë *autoveturë*, me targë: \*\*\*, marka *Rover*.

## **16. Shpenzime shkollimi dhe jetese për personin e lidhur, znj. \*\*\*,\*\*\*, vajza e subjektit të rivlerësimit**

16.1 Në D-Vett. dhe në deklaratat periodike vjetore nuk rezultojnë që subjekti i rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të, të kenë deklaruar shpenzime shkollimi dhe jetese për personin e lidhur, znj. \*\*\*,\*\*\*.

16.2 Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë \*\*2.2016<sup>15</sup>, i pyetur se ku studiojnë fëmijët e tij, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] \*\*\*,\*është studente në Universitetin publik të Vlorës, Fakulteti Ekonomik [...].

16.3 Nga informacioni i përcjellë nga institucionet financiare<sup>16</sup>, rezultojnë disa dërgesa në monedhën euro drejt Austrisë, për periudhën 2014-2017, me përfituese shtetasen \*\*\*,\*\*\*. Nga llogaria në euro në \*\*\* Bank, e personit të lidhur, znj. \*\*\*, kanë rezultuar transferta ndërkombëtare, përkatësisht në vitin 2014, në shumën 800 euro, me përshkrimin: “*payment for rent*” dhe në vitin 2015, në shumën 1.300 euro, me përshkrimin: “*payment for school*”.

16.4 Në përgjigje të pyetësorit standard, lidhur me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr.10, ka deklaruar lidhur me shkollimin e vajzave të tij në Shqipëri, ndërsa në përgjigje të pyetjes nr.17, është përgjigjur: [...] *Kam nisur të holla cash në drejtim të Austrisë, Vjenës për vajzën time, \*\*\*, pasi kërkonte të fillonte studimet dhe kursin e gjuhës gjermane. Duke mos gjetur një punë të përhershme, nuk filloi studimet [...].*

16.5 Komisioni i është drejtuar përsëri subjektit, pasi në lidhje me pyetjen nr.10 të pyetësorit standard, duket se shpjegimet e dhëna janë të përgjithshme dhe jo shteruese. Gjithashtu i ka kërkuar të shpjegojë më konkretisht duke iu referuar datave të sakta, vitet kur fëmijët kanë ndjekur arsimin e lartë dhe tarifën përkatëse vjetore të paguar për shkollim, të specifikuar për secilin vit.

16.6 Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është përgjigjur: [...] \*\*\*,\*ka aplikuar për të ndjekur programin Bachelor në “Shkencat Ekonomike”, në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit të Vjenës, për vitin akademik 2015-2016. Vajza ka shkuar në Vjenë në datë \*\*1.2015 dhe për qëndrimin ka paguar nga llogaria e bashkëshortes shumën 800 euro në datën \*\* dhjetor 2014. Ka qëndruar për disa kohë në apartamentin e marrë me qira dhe rreth muajit shkurt 2015 ka qëndruar në Konvikt \*\*\*, Linzer Str. \*\*\*, \*\*\* Vien, me pagesë qiraje mujore 300 euro/muaj. Deri në muajin nëntor 2016 ka qëndruar në këtë konvikt gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Vjenë. Shpenzimet e shkollimit janë dërguar nga bashkëshortja në llogarinë e vajzës (për të cilën nuk disponoj kopje të lëvizjeve të llogarisë, por kanë qenë vetëm transfertat e kryera nga ana jonë, të cilat janë tërhequr prej saj) ... Në vitin 2016 nuk vazhdoi më programin Bachelor në Universitet, por filloi kursin e gjuhës. Nuk disponojmë dokumentacion justifikues për pagesën e kursit të gjuhës, po nga sa më informon vajza, ka paguar rreth 2,500 euro tarifë (paguar në dy pjesë, gjatë vitit 2016 dhe 2017). Në muajin nëntor 2016 deri kur është kthyer përfundimisht, në korrik 2017, ka qëndruar në apartamentin e marrë me qira [...].

<sup>15</sup> Referohuni procesverbalit datë \*\*2.2016, përcjellë nga ILDKPKI, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*5.2022.

<sup>16</sup> Referohuni informacionit të përcjellë Komisionit nga AK-Invest, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*9.2020, dhe \*\*\* Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*12.2020, që kanë konfirmuar disa dërgesa në monedhën euro, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, bashkëshortja dhe vajza, \*\*\*,\*\*\*, drejt Austrisë.

16.7 Komisioni, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion justifikues vetëm lidhur me shpenzimet e akomodimit të vajzës, për periudhën nëntor 2016 - prill 2017, ka llogaritur në analizën financiare paraprake shpenzime jetese sipas të dhënave të Eurostat-it<sup>17</sup>.

16.8 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi ka konstatuar se: (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën “Vetting” shpenzimet e kryera për shkollimin dhe jetesën e vajzës në Vjenë, si dhe nuk i ka deklaruar ato as në deklaratimet periodike vjetore.* (ii) *Subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare në fund të vitit 2015, në shumën -1.606.763 lekë, dhe në vitin 2016, në shumën -661.813 lekë, për pagesën e shpenzimeve të vajzës së tij.*

16.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka kërkuar që Komisioni të llogarisë përkatësisht, shpenzime për vajzën e tij për 6 muaj qëndrim në Austri, në vitin 2015 dhe për 5 muaj qëndrimi në Austri, për vitin 2016. Gjithashtu ka pretenduar që llogaritja e shpenzimeve mesatare të jetesës të mos bëhet sipas të dhënave të Eurostat-it, pasi sipas tij, shpenzimet mujore gjithsej kanë qenë jo më shumë se 750 euro në muaj. Në vijim, subjekti ka deklaruar se për periudhën 6-mujore, në vitin 2015, shpenzimet e qëndrimit në Austri të vajzës janë në vlerën 5.500 euro (4.200 euro për jetesë dhe qira konvikti dhe 1.300 euro aplikim për shkollë) ndërsa për periudhën 5-mujore, në vitin 2016, këto shpenzime janë 5.000 euro (750 euro në muaj për jetesë dhe 1.250 euro pagesë për kursin e gjuhës)<sup>18</sup>. Bashkëlidhur shpjegimeve, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion për të provuar shpenzimet e akomodimit të vajzës, për periudhën shkurt 2015 – gusht 2015, të cilat i referohen qëndrimit të vajzës së tij në konvikt, me kosto 302 euro/muaj, si dhe ka deklaruar se nga muaji shtator 2016 deri në mes të muajit dhjetor 2016, vajza ka qëndruar në apartamentin e shoqes së saj, \*\*\*.\*\*\*<sup>19</sup>.

16.10 Komisioni, në përfundim, për shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së vajzës, znj. \*\*\*.\*\*\*, arrin në këto përfundime:

*[...] duke iu referuar të dhënave në faqen zyrtare të Ambasadës Austriake, për shpenzime jetese për studentë nën 24 vjeç, që duan të studiojnë në Austri<sup>20</sup>, rishikoi analizën financiare për vitet 2015 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit del për vitin 2015 me balancë negative në vlerën -133.127 lekë, dhe për vitin 2016 rezultoi me balancë pozitive për përballimin e shpenzimeve të shkollimit [...].<sup>21</sup>*

*[...] Lidhur me mosdeklarimet nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën “Vetting” të këtyre shpenzimeve, Komisioni vlerëson se, gjatë hetimit administrativ, gjenden gjurmë të pakontestueshme se këto shpenzime janë kryer si transferta bankare, pagesa nëpërmjet \*\*\* dhe se këto shpenzime janë deklaruar në pyetësorin standard të Komisionit që në fillimin e hetimeve, duke mos penguar hetimet për këtë veprimtari. Megjithëse pasaktësitë në deklaratim mbeten, ato nuk mund të konsiderohen në kuadër të procesit të rivlerësimit, se plotësojnë*

<sup>17</sup>Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 12-13 të vendimit. Sipas të dhënave të Eurostat-it shpenzimet e jetesës në Austri janë rreth 1.160 euro në muaj.

<sup>18</sup>Referohuni dokumentit me emërtim “Observacion i prokurorit Robert Kote, për të vërtetuar të kundërtën dhe në përgjigje të barrës së provës”, f. 7-8.

<sup>19</sup>Subjekti ka depozituar deklaratë të shtetasës \*\*\*.\*\*\*, datë \*\*.11.2022.

<sup>20</sup> Referuar në f.13 të vendimit të Komisionit, sipas të dhënave nga kjo faqe, duhet të përballojnë shpenzime qëndrimi/jetese në shumën 515 euro/muaj, për studentë, për vitin 2019.

<sup>21</sup> Shihni f.13, pika 20.17 e vendimit.



ndonjë nga kushtet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ato nuk të konsiderohen të tilla që mund të gjejnë zbatim[...].<sup>22</sup>

16.11 Komisioneri Publik, lidhur me shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës të vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj. \*\*\*.\*\*\*, në Vjenë, Austri vëren sa vijon:

16.11.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë deklaruar shpenzime shkollimi dhe jetese të vajzës në Vjenë, Austri.

16.11.1.1 Po në këtë deklaratë në rubrikën: “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, ku duhen deklaruar detyrimet financiare dhe qëllimi i detyrimit financiar, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*me datë \*\*.3.2016 është financuar me një kredi nr. \*\*\*, në shumën 500.000 lekë*”, pa specifikuar qëllimin e detyrimit financiar.

16.11.1.2 Në përgjigje të pyetësorit të datës 24.5.2022, subjekti i rivlerësimit deklaroi qëllimi i përdorimit të kredisë së marrë në datën \*\*.3.2016, në \*\*\* Bank, është për arsye të përballimit të shpenzimeve të qëndrimit të vajzës në Vjenë, ndërsa në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, në datën \*\*.5.2021, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 7, ka deklaruar se qëllimi i kredisë ka qenë për pushime dhe udhëtime.

16.11.2 Në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë deklaruar shpenzime për shkollimin dhe jetesën e vajzës në Vjenë, Austri, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit nr. 9049/2003, “*Për deklarimin ...*”, i ndryshuar. Mosdeklarimi vijon dhe në përgjigje të pyetësorit standard dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë \*\*.2.2016.

16.11.3 Në përgjigje të pyetësorit datë 24.5.2022 dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion lidhur me shpenzimet e akomodimit të vajzës së tij, për periudhat *shkurt 2015-gusht 2015 dhe nëntor 2016-prill 2017*, ndërsa nuk ka paraqitur dokumentacion për periudhën e mbetur. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me shpenzimet e jetesës, shpenzimet e shkollimit, shpenzimet e kurseve të ndjekura etj. Gjithashtu rezultoi që nuk janë depozituar *nxjerrjet e llogarive bankare të vajzës, znj. \*\*\*.\*\*\*, në Austri*<sup>23</sup>.

16.11.4 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me akomodimin e vajzës së tij në Vjenë, në përgjigjet e pyetësorit datë 24.5.2022, ka deklaruar: [...] *Vajza ka shkuar në Vjenë në datën \*\*.1.2015 dhe për qëndrimin ka paguar nga llogaria e bashkëshortes shumën 800 euro, në datë \*\* dhjetor 2014. Ka qëndruar për disa kohë në apartamentin e marrë me qira dhe rreth muajit shkurt 2015 ka qëndruar në Konvikt \*\*\*, Linzer Str. \*\*\*, \*\*\* Vien, me pagesë qiraje mujore 300 euro/muaj. Deri në muajin nëntor 2016 ka qëndruar në këtë konvikt gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Vjenë [...] ndërsa, në përgjigjet të rezultateve të hetimit, në ndryshim nga sa më sipër, ka deklaruar se, për periudhën shtator deri në mesin e muajit dhjetor 2016, ka qëndruar në apartamentin e shoqes së saj, \*\*\*.\*\*\*. Këto pohime të subjektit bien ndesh dhe me sa ka deklaruar ai në përgjigje të pyetësorit standard, i pyetur nga Komisioni lidhur me udhëtimet jashtë vendit dhe adresat ku kanë qëndruar subjekti dhe familjarët e tij gjatë këtyre udhëtimeve*<sup>24</sup>.

<sup>22</sup> Shihni f.14, pika 20.18 e vendimit

<sup>23</sup> Referuar akteve në dosje të Komisionit, rezultoi se personi i lidhur, znj. \*\*\*.\*\*\* ka kryer transferat bankare në drejtim të llogarisë bankare të znj. \*\*\*.\*\*\* në Austri, si dhe në Deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep, dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.4.2015, citohet llogari bankare në emër të znj. \*\*\*.\*\*\*, në Austri.

<sup>24</sup> Referohuni dokumentit të depozituar nga subjekti “UDHËTIME JASHTË SHTETIT”, bashkëlidhur pyetësorit standard.

16.11.5 Shumat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si shpenzime jetese për vajzën e tij në Austri, përveçse nuk janë deklaruar dhe nuk mbështeten me dokumentacion justifikues ligjor, janë më të ulëta se shpenzimet bazuar në të dhënat e Eurostat-it.

16.11.6 Në dosjen e Komisionit janë administruar disa deklarata noteriale të viteve 2014-2016<sup>25</sup>, ku subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij deklarojnë se marrin përsipër të mbulojnë shpenzime shkollimi dhe qëndrimi të vajzës së tyre, \*\*\*.\*\*\* në Vjenë, Austri. Në këto deklarata citohen vlerat 800 euro në muaj dhe 2.000 euro në muaj.

16.12 Në përfundim, lidhur me shpenzimet e shkollimit dhe jetesës të vajzës, znj. \*\*\*.\*\*\*, në Vjenë, Austri, Komisioneri Publik çmon se, si pasojë e mosdeklarimit të këtyre shpenzimeve në D-Vetting dhe deklaratat periodike vjetore, deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe mungesa e një dokumentacioni të plotë justifikues ligjor lidhur me këto shpenzime, krijojnë pamundësinë për të verifikuar se cilat ndër deklaramet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike dhe, për rrjedhojë, pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

### **III.A/1 Konstatime të tjera**

#### **17. Pasuria “autoveturë” me targë: \*\*\*, marka “Audi A4”**

17.1 Nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton se në vitin 2016, përveç shpenzimeve të shkollimit dhe shpenzimeve të tjera të kryera nga subjekti dhe personat e lidhur me të, konstatohet se është blerë pasuria *autoveturë* me targë: \*\*\*, marka *Audi A4*, në vlerën 1.320.000 lekë.

17.2 Në DV-2016, lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Blerje në shumën 1.000.000 lekë dhe shitje e autoveturës Audi A4, në shumën 980.000 lekë (Për mospërmbushje të detyrimeve financiare).*

17.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2020, ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Audi A4”, me targa: \*\*\*. Nga aktet bashkëlidhur rezulton se, me Kontratë shitje datë \*\*.6.2016, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator shtetasin \*\*\*.\*\*\*, automjetin e mësipërm në vlerën 1.320.000 lekë. Në kontratë specifikohet se kjo shitje bëhet në bazë të faturës tatimore nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2016. Sipas Certifikatës së Pronësisë, datë \*\*.6.2016, automjeti është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

17.4 Në datën \*\*.7.2016, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e shitësit, ka nënshkruar Kontratë shitje nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\* kol., me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, për shitjen e automjetit me targa: \*\*\*. Palët deklarojnë se mjete i mësipërm i shitet blerësit \*\*\*.\*\*\*, në shumën 980.000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

17.5 Komisioni, për pasurinë *autoveturë* me targë: \*\*\*, marka *Audi A4*, arrin në përfundimin<sup>26</sup> se: [...] *ky veprim është kryer brenda vitit të deklarimit, pasi subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e tij, prandaj e ka kthyer këtë automjet te shitësi i tij, duke mos konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri [...].*

17.6 **Komisioneri Publik**, lidhur me pasurinë *autoveturë* me targë: \*\*\*, marka *Audi A4*, vëren sa vijon:

<sup>25</sup> Referohuni akteve të përcjella nga noteri \*\*\*.\*\*\*, në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2022.

<sup>26</sup> Shihni f. 7, pikat 18.5, 18.6 të vendimit.

17.6.1 Në DV-2016, subjekti ka deklaruar blerjen dhe shitjen e këtij automjeti brenda vitit për mospërmbushje të detyrimeve financiare.

17.6.2 Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI, në datën \*\*.5.2021, në përgjigje të pyetjes nr. 3, subjekti ka deklaruar: [...] *Në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e mjetit me targë: \*\*\* kanë shërbyer fondet e krijuara nga shitja e mjetit "Audi", me targë: \*\*\*, në shumën 980.000 lekë, në datën \*\*.7.2016. Në lidhje me këto fonde sqaroj se i kam marrë nga blerësi në mënyrë periodike, deri në datën kur unë kam blerë mjetin me targë: \*\*\*, për këtë arsye, unë nuk kam deklaruar gjendje cash në fund të vitit 2016[...].*

17.7 Në përfundim, lidhur me mundësinë e blerjes së pasurisë *autoveturë*, me targë: \*\*\*, marka *Audi A4*, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe kontradiktore, duke mbetur e paqartë se sa ka qenë shuma e paguar nga subjekti i rivlerësimit në momentin e blerjes së kësaj pasurie dhe sa ka qenë detyrimi i papërmbushur, ndaj jemi në pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

17.8 Referuar të dhënave financiare të administruara në dosje të Komisionit, rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, deri në datën \*\*.6.2016, kur është blerë ky automjet, janë rreth 1.055.000 lekë<sup>27</sup>. Kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme blerjen e këtij automjeti në vlerën 1.320.000 lekë dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, që më së paku përlllogariten në vlerën 800.000 lekë<sup>28</sup>.

## **18. Ambient shërbimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën "\*\*\*\*", Tiranë**

18.1 Në DV-2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e një kredie në shumën 30.000 euro, por nuk ka deklaruar qëllimin e detyrimit financiar.

18.2 Nga aktet në dosje të Komisionit rezultojnë këto rrethana:

18.2.1 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave<sup>29</sup> ka informuar Komisionin, se nga të dhënat e raportuara nga bankat, rezulton e lidhur kontratë paraprake shitje me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.2.2017, me palë blerëse \*\*\*\*.\*\*\* dhe palë shitëse shoqërinë "\*\*\*\*" sh.p.k., për vlerën 45.000 euro.

18.2.2 Nga korrespondenca<sup>30</sup> me noteren \*\*\*.\*\*\* janë vënë në dispozicion: (i) Kontratë paraprake shitje me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.2.2017, me palë shitëse shoqërinë "\*\*\*\*" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori \*\*\*.\*\*\* dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit Robert Kote. Objekti është një njësi shërbimi me sipërfaqe 68m<sup>2</sup>, *ende e paregjistruar në ZRP Tiranë*, me çmim 45.000 euro. (ii) Kontratë paraprake shitje me nr. \*\*\* rep. dhe nr.\*\*\* kol., datë \*\*.3.2017, me të njëjtat palë dhe objekt.

18.2.3 \*\*\* Bank i ka përcjellë<sup>31</sup> Komisionit dokumentacionin lidhur me kredinë në shumën 30.000 euro, marrë nga subjekti i rivlerësimit pranë kësaj banke, nga ku rezultojnë këto

<sup>27</sup> Të ardhurat nga paga e subjektit, kredituar në \*\*\* Bank janë rreth 735.000 lekë; të ardhurat e bashkëshortes, kredituar në \*\*\* Bank janë rreth 246.000 lekë, të ardhurat nga pensioni i bashkëshortes, sipas shkresës së ISSH-së nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2016, llogariten në vlerën rreth 74.000 lekë. Rezulton që në mars të vitit 2016 është marrë dhe një kredi në shumën 500.000 lekë, në \*\*\* Bank, për të cilën, sikurse është trajtuar në këtë ankim, subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore lidhur me qëllimin e marrjes së saj.

<sup>28</sup> Rezulton që gjatë kësaj periudhe, familja e subjektit të ketë pasur shpenzime jetese në Shqipëri rreth 400.000 lekë, në Austri (nuk mund të përlllogariten), shpenzime kredie rreth 130.000 lekë, si dhe ka bërë një depozitim *cash* në \*\*\* Bank, në shumën 270.000 lekë, në datën \*\*.6.2016, për mbyllje Overdrafti etj.

<sup>29</sup> Shihni shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2020, në dosje të Komisionit.

<sup>30</sup> Shihni shkresën me nr. extra prot., datë \*\*.9.2022, shkresa me nr. extra prot., datë \*\*.6.2022, në dosje të Komisionit.

<sup>31</sup> Shihni shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2020, në dosje të Komisionit.

akte/dokumente shkresore: (i) kontratë huaje me nr.\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.3.2017, me palë huamarrëse Robert e \*\*\*.\*\*\*, për shumën 30.000 euro, me qëllim blerjen e një pasurie me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup> e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë; (ii) dy mandate arkëtimi, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përkatësisht mandatarkëtimin nr. \*\*, datë \*\*.2.2017, në shumën 10.000 euro, dhe mandatarkëtimin nr. \*\*, datë \*\*.2.2017, në shumën 5.000 euro; (iii) Transferim fondesh, i datës \*\*.3.2017, me përshkrimin: “*Kalim nga Robert Kote te \*\*\*\* sh.p.k., pagesë kësti 2, sipas kontratës nr.\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.3.2017*”; (iv) kontratë hipoteke me nr.\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.3.2017, me hipotekues \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, për kredinë 30.000 euro, ku hipoteke në favor të Bankës është pasuria me nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, njësi me sipërfaqe 116m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*\*, Tiranë.

18.2.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>32</sup> ka përcjellë vendimet gjyqësore penale të formës së prerë për personin e hetuar \*\*\*.\*\*\*, në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*/2017 dhe nr. \*\*\*/2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si dhe Prokuroria e Tiranës<sup>33</sup> për procedimet penale ku shtetasi \*\*\*.\*\*\* ka qenë në cilësinë e personit në hetim për veprën penale “përshtatje e lokalit për përdorim droge” dhe “prodhim dhe shitje narkotikësh”, në përfundim të hetimeve paraprake është vendosur pushimi i akuzës.

18.2.5 Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në shkresën *pa nr. prot.*, datë \*\*.6.2022, e nënshkruar, pa gjeneralitete se kujt i përket nënshkrimi, informon për kontratën paraprake të shitjes të pasurisë së paluajtshme “ambient shërbimi”, me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, kontratë e cila është revokuar me vullnet të plotë e të lirë me marrëveshje nga të dyja palët. Bashkëlidhur shkresës janë përcjellë mes të tjerash këto akte/dokumente: (i) Kontratë paraprake shitje me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.3.2017, me palë shitëse \*\*\*\* sh.p.k., përfaqësuar nga administratori \*\*\*.\*\*\* dhe palë blerëse Robert Kote, me objekt: blerje ambient shërbimi, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, për çmimin 45.000 euro; (ii) Një dokument i quajtur *Revokim kontrate*, me datë \*\*.4.2017, ku deklarues është \*\*\*.\*\*\* dhe Robert Kote, dhe nënshkruer \*\*\*.\*\*\* dhe Robert Kote, me përmbajtje deklarimin se revokojmë kontratën paraprake të shitjes me vullnet të plotë, të lirë, me marrëveshje mes njeri-tjetrit; (iii) Kontratë porosie e datës \*\*.11.2017, me porositës \*\*\*.\*\*\*, ku rezulton se *kësti i parë* është paguar 12.000 euro, më datë \*\*.11.2014 dhe kësti i dytë është paguar 15.000 euro, më datë \*\*.11.2015, dhe kontratë shitje e datës \*\*.1.2018, ku konfirmohen pagesat sipas kontratës së porosisë; (iv) Njoftim i lëshuar në datën \*\*.10.2017, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për vënien në dijeni për të tërhequr të hollat e marra nga kredia në \*\*\* Bank, pasi njësi e shërbimit i është shitur palës tjetër, \*\*\*.\*\*\*.

18.2.6 Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tirana Veri<sup>34</sup> ka depozituar dokumentacionin lidhur me pasurinë *Njësi shërbimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>*, nga e cila rezulton se pasuria me nr. \*\*\*, është regjistruar më datë \*\*.2.2017, në emër të “\*\*\*\*” sh.p.k., për të cilën i është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie. Gjithashtu, pjesë e praktikës shkresore është kontrata e shitjes e datës \*\*.1.2018 dhe Kartela e Pasurisë së Paluajtshme, ku pasuria me nr. \*\*\* është në pronësi të shtetasës \*\*\*.\*\*\*, dhe referuar mandateve bashkëlidhur rezulton se një pjesë e çmimit, rreth 27.000 euro, janë paguar në vitet 2014-2015.

18.2.7 Nga verifikimi i të dhënave historike në ekstraktin e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., Komisionit i ka rezultuar se, në datën \*\*.7.2014, ortaku i vetëm, shtetasi \*\*\*.\*\*\*, vendos largimin e tij nga detyra si administrator dhe emëron në detyrën e administratorit shtetasin \*\*\*.\*\*\*, si dhe kalon 100% të kuotave të shoqërisë në favor të shtetasit \*\*\*.\*\*\*. Gjithashtu, nga të dhënat e nxjerra nga burimet e hapura, Komisioni ka rënë në dijeni se shtetasi \*\*\*.\*\*\*

<sup>32</sup> Shihni shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2022 dhe me nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2022, në dosje të Komisionit.

<sup>33</sup> Shihni shkresën me nr. \*\*\* prot. , datë \*\*.10.2022, në dosje të Komisionit.

<sup>34</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2022.

është ndaluar më \*\*.7.2017 nga shërbimet policore, pasi rezultoi i dënuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

18.2.7.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka përcjellë praktikën e ekzekutimit të vendimit penal, në ngarkim të shtetasit \*\*\*, nga ku rezultoi se: (i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin penal nr.\*\*, datë \*\*.5.2015, e ka dënuar me 1 vit e 4 muaj burgim për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyrë” dhe, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin penal të datës \*\*.9.2016, ku është vendosur ndryshimi i dispozitivit për sa i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burg. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës \*\*.5.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me fajësinë, cilësimin ligjor dhe llojin e masës së dënimit, si dhe ndryshimin e tij lidhur me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke lënë në fuqi vendimin e datës \*\*.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

18.3 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, ndër të tjera, ka deklaruar: *Në vitin 2017 kam lidhur Kontratë Paraprake Shitje nr. \*\*, me shoqërinë \*\* sh.p.k., për blerjen e një ambienti shërbimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup> në rrugën “\*\*\*\*”. Në nenin 3 të kontratës është përshkruar se kësti i parë, në shumën 10,000 euro, do të likuidohet jashtë zyrës noteriale, kësti i dytë me marrjen e një kredie dhe kësti i tretë, në shumën 5,000 euro, në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes dhe hipotekimit të ambientit në emrin tim. Diferencën prej 15,000 euro nuk e disponoja dhe i kisha kërkuar kumatit tim borxh për plotësimin e të gjithë vlerës së detyrimit, duke më mundësuar blerjen dhe pagesën totale të këtij ambienti. Në kushtet kur prej tij nuk u arrit mundësia për të më dhënë diferencën dhe nuk doja të merrja borxh diku tjetër, unë i kam paguar fillimisht shitësit vetëm vlerën prej 30,000 euro. Shitësi më ka pritur pothuajse deri në fund të muajit prill për përmbushjen e detyrimit, në kushtet kur nuk arrita të siguroja diferencën e çmimit, të dyja palët, si unë ashtu, edhe shitësi, kemi firmosur kontratën e revokimit, që mban datën \*\* prill 2017... Mandati prej 10.000 euro është nënshkruar midis meje dhe shoqërisë për të plotësuar kushtin e marrjes së kredisë, pasi banka nuk disbursonte kredinë në rast të mosdokumentimit të likuidimit të kështit të parë.*

18.4 Komisioni, në përfundim arsyeton<sup>35</sup>: [...] në vlerësim të tërësisë së veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe situatës së rezultuar nga hetimi, ka krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh, të cilat duket se kanë pasur për qëllim vetëm marrjen/përfitimin e kredisë bankare në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar pasuri. Objekti i porositur nga subjekti i rivlerësimit, njësi shërbimi nr. \*\*, sipas kontratës paraprake të shitjes, përputhet me objektin e blerë e të paguar nga shtetasja \*\*\*, dhe të regjistruar në hipotekë. Këto veprime janë kryer pas Deklaratës “Vetting” dhe janë vlerësuar e trajtuar nga organi kompetent, ILDKPKI-ja. Duke qenë se kjo situatë nuk është brenda periudhës së rivlerësimit, ajo duhet t’i nënshtrohet kontrollit nga organet kompetente për vlerësimin e pasurisë, çka edhe ka ndodhur nëpërmjet kontrollit nga ILDKPKI-ja në vitin 2021, për të cilën subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*, datë \*\*.10.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, ka marrë masën administrative përkatëse [...].

18.5 Komisioni, gjithashtu, për shtetasin \*\*\*, ka arritur në përfundimin<sup>36</sup> se: [...] Në vlerësim të kontaktit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin \*\*\*, trupi gjykues nuk gjen elemente apo rrethana për ta konstatuar këtë shtetas një person të përfshirë në krimin e

<sup>35</sup>Shihni f.11, pika 19.11 e vendimit.

<sup>36</sup> Shihni f. 24, pika 38 e vendimit.

organizuar, as marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas të tillë që cenon standardin e besueshmërisë së një prokurori. Në këtë konkluzion, trupi gjykues ka arritur duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimet e konsoliduara nga jurisprudenca, sipas të cilave, shkëlja e rëndë etike, sipas përcaktimeve kushtetuese, duhet të jetë e një niveli që e bën prokurorin të padenjë për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë [...].

18.6 Komisioneri Publik vëren se rrethanat që rezultojnë nga hetimi në Komision, provojnë se: (i) administratori apo përfaqësuesi me prokurë i këtij të fundit për shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. rezulton shtetasi \*\*\*.\*\*\* dhe përfaqësues me prokurë, shtetasi \*\*\*.\*\*\*; (ii) konstatohet se për pasurinë objekt i kontratës paraprake për shitje, e datës \*\*.3.2017 (edhe pse e pa individualizuar me të gjitha elementet identifikuese) ka pasur kontratë porosie me shtetasen \*\*\*.\*\*\*, sipas të cilës janë shlyer edhe dy këste, në periudhën 2014-2015; (iii) rezulton se kjo pasuri është regjistruar në pronësi të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. në datën \*\*.2.2017, pra rezulton i pavërtetë formulimi në kontratën paraprake të shitjes, e datës \*\*.3.2017, se pasuria është ende e paregjistruar; (iv) rezulton se subjekti i rivlerësimit, për të provuar kthimin e shumës 29.446 euro, nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., ka depozituar disa mandatpagesa, nga ku konstatohet se kthimi i këtyre shumave ka filluar vetëm 3 ditë pasi kredia nga \*\*\* Bank është transferuar në favor të shoqërisë. Madje, disa prej këtyre mandateve datojnë përpara dokumentit të quajtur *Revokim kontrate*, të datës \*\*.4.2017.

18.7 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se këto rrethana të çojnë në konkluzionin e veprimeve fiktive në dukje të subjektit të rivlerësimit, në këtë marrëdhënie shitblerje me kusht, një sjellje me karakter përsëritës e tij apo në alternativën tjetër të pamundësisë financiare për të paguar shumën 15,000 euro, në muajin shkurt 2017.

18.8 Përveç sa më sipër, marrëdhëniet e subjektit të rivlerësimit me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, si person i dënuar në momentin e nënshkrimit të kontratave paraprake të shitjes apo me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, për të cilin deklaroi miqësi 25-vjeçare, janë sjellje të cilat duhen parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që cenojnë besimin e publikut te drejtësia.

### **III.B Lidhur me gjetjen në raportin e DSIK-së**

19. Gjatë hetimit për kontrollin e figurës, DSIK-ja, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, ka përcjellë pranë Komisionit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022, Raportin<sup>37</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në të cilin informohet se:[...] *evidentohet vetëm një e dhënë [redacted] mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës [redacted]* [...].

20. Komisioni, nisur nga informacioni i përcjellë nga organet ligjzbatuese, ndër të tjera, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë<sup>38</sup>, e cila ka vënë në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*/2016.

#### **20.1 Procedimi penal nr. \*\*\*/viti 2016**

20.1.1 Komisariati i Policisë Nr. 5, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë \*\*.12.2016, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, materialet procedurale mbi arrestimin në flagrancë të shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, për ngjarjen e ndodhur më datë \*\*.12.2016, në “\*\*\*”, Kamëz, Tiranë, e cila bën fjalë për veprën penale:

<sup>37</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022.

<sup>38</sup> Referohuni shkresës kthim përgjigje, me nr.\*\*\* prot., datë \*\*.10.2022.

“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278, paragrafi 2, dhe neni 25 i Kodit Penal.

20.1.2 Shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* janë arrestuar në flagrancë, pasi në datën \*\*.12.2016, rreth orës 10.30, në vendin e quajtur rruga “\*\*\*”, Kamëz, Tiranë, janë kapur në flagrancë nga shërbimet e rendit dhe të krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 5, me dy arka metalike, me përmasat 40 x 15 x 15 cm., si ato të aluminit të mbyllura, ku brenda gjendej municion luftarak i kalibrit 7.62 mm. Oficeri i Policisë Gjyqësore, në zbatim të dispozitave procedurale penale, ka kryer veprimet e nevojshme dhe, bazuar në nenin 293 të Kodit të Procedurës Penale, ka përpiluar referimin e veprës penale te Prokurori. Materialet procedurale, që shoqërojnë referimin, janë për secilin nga shtetasit e arrestuar në flagrancë, konkretisht *procesverbalet* e arrestimit në flagrancë, e kontrollit personal, e kontrollit të banesave/vendeve, e marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, për sekuestrimin e sendeve, për fiksime prove, si dhe vendimi për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit teknik, ku sasia e fishekëve ndodhur brenda arkave referohet **1440** fishekë.

20.1.3 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale, të parashikuar në nenin 278/2 të Kodit Penal, në ngarkim shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*. Pas regjistrimit të procedimit penal me nr. \*\*\*, të vitit 2016, ka marrë vendime që lidhen me vleftësimin e sekuestros të dy arkave me fishekë, ku gjenden 1440 fishekë, të mjetit tricikël pa targa me një karroceri, si dhe më datë \*\*.12.2016, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me kërkesën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit. Sipas kërkesës drejtuar gjykatës për shtetasin \*\*\*.\*\*\* është kërkuar vleftësimi i ligjshëm: “*i arrestit në flagrancë*” dhe caktimin e masës së sigurimit: “*Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore*” dhe për shtetasin \*\*\*.\*\*\* është kërkuar vleftësimi i ligjshëm: “*të arrestit në flagrancë*” dhe caktimin e masës së sigurimit: “*arrest në burg*”. Gjykata, me vendimet e datës \*\*.12.2016, ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të “*arrestit në flagrancë*” dhe caktimin si masë sigurimi për të dy personat nën hetim “*detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore*”.

20.1.4 Më datë \*\*.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin: *për pushimin e hetimit për procedimin penal me nr. \*\*\*, të vitit 2016*. Në pjesën arsyetuese të vendimit, pasi përshkruan ngjarjen, subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se provohet se personat nën hetim, \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, me veprimet e tyre aktive, që konsistojnë në mbajtjen pa leje të municioneve luftarake të fishekëve, me qëllim shitjen e tyre, kanë kryer veprën penale të: “Mbajtjes pa leje të municioneve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal, veprë penale kjo e kryer para datës \*\*.12.2016. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie Amnistie”, në datën 14.1.2017, vepra penale e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal amnistohet dhe, për këtë arsye, ndjekja penale për këtë veprë penale dhe ndaj autorit duhet të pushohet. Sa më sipër, duke qenë se ekziston një shkak për të cilin ndjekja penale nuk mund të vazhdojë, bazuar në kërkesat e nenit 6 të ligjit nr. 141/2016, datë 22.12.2016, “Për dhënie amnistie”, nenit 71 të Kodit Penal dhe neneve 328/1, pika “d”, 329 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: *pushimin e procedimit penal*. Në pjesën detyruese të vendimit, ndër të tjera, është disponuar: (i) *për shuarjen e masës së sigurimit personal “detyrim për paraqitje në Policinë gjyqësore”, në zbatim dhe të nenit 261/1/c të Kodit të Procedurës Penale;* (ii) *kthimin e mjeteve ... dhe kalimin në favor të shtetit të 1440 fishekëve,*

të sekuestruar me procesverbalet e sekuestrimit të datës \*\*.12.2016, në zbatim të nenit 190 të K.P.P.

20.1.5 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] (3.6) *duket se prokurori Robert Kote nuk ka bërë një kualifikim të drejtë të veprës penale, e cila ka sjellë për pasojë pushimin e procedimit penal dhe shuarjen e masës së sigurisë, kthimin e automjeteve dhe kalimin në favor të shtetit të municioneve luftarake (fishekë) të sekuestruar, për shkak edhe të ligjit për amnistinë*<sup>39</sup> [...].

20.1.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] *Çështja penale objekt i verifikimit të Komisionit është regjistruar dhe kualifikuar nga ana ime sipas vlerësimit dhe bindjes time të brendshme dhe ashtu siç ka referuar edhe Policia Gjyqësore. Në momentin e regjistrimit kam çmuar se vepra penale, e kryer nga shtetasi \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, duhej të kualifikohej sipas nenit 278/2 të Kodit penal dhe jo sipas nenit 278/5, sepse në vlerësimin Tim, për të kryer kualifikimin sipas figurës së veprës penale të parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni, duhet të vërtetoheshin njëkohësisht se transportimi është kryer me qëllim tregtimi, fakt i cili nuk provohej nga aktet e ndodhura në dosje. Pavarësisht sa më sipër, kualifikimi i veprës penale është kryer nga ana ime bazuar në bindjen time të brendshme dhe pa u ndikuar nga rrethanat të tjera njëanshmërie. Në momentin e regjistrimit të kësaj çështje penale, neni 278 sapo ishte riformuluar dhe nuk ka pasur praktikë të konsoliduar për veprimin e kundërligjshëm të transportimit të municioneve. Para ndryshimeve të vitit 2016, në nenin 278 të Kodit Penal, nuk parashikohej si formë e veçantë e anës objektive transportimi i municioneve (por vetëm prodhimi dhe mbajtja)*<sup>40</sup>[...].

20.1.7 Në përfundim, Komisioni, ndër të tjera, ka vlerësuar: [...] *këto konstatime nuk mund të vlerësohen në kuadër të vlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, por ato mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të tij, në kontekstin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016*<sup>41</sup>... si dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit në mënyrën e interpretimit të çështjes, në procedimin penal nr. \*\*\*/2016, kanë një logjikë në interpretimin e tyre, lidhur me vetë problematikën e konstatuar në ndryshimet/interpretimin e nenit 278 të Kodit Penal dhe se qëndrimi i tij, gjithashtu, ka qenë në një linjë me qëndrimin e Policisë Gjyqësore, që ka referuar veprën, e cila kishte bërë kapjen në flagrancë të autorëve. Pavarësisht se trupi gjykues çmon se qëndrimi i prokurorit vjen si pasojë e një hetimi të pathelluar dhe i një vlerësimi sipërfaqësor të fakteve që kanë rezultuar nga provat e administruara, duke vlerësuar se është bërë një zbatim i gabuar i dispozitës materiale për çështjen konkrete në gjykim, çmon gjithashtu se ky vlerësim ka të bëjë me thelbin e zgjidhjes së çështjes dhe bindjen e prokurorit, ndaj nuk duhet të gjykohet e vlerësohet nga ky trup gjykues në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Trupi gjykues çmon se shkelja e kryer në rrethanat e lartpërmendura na çon në konkluzionin se ajo nuk mund të konsiderohet si shkelje haptazi dhe në kundërshtim flagrant me ligjin dhe, për pasojë, të kualifikohen si shkelje të rënda profesionale. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se vetëm zgjidhja e kësaj çështjeje në këtë mënyrë, e vlerësuar në tërësinë e

<sup>39</sup> Shihni f.13 të aktit “Relacion mbi rezultatet e hetimit Robert Kote”, të Komisionit.

<sup>40</sup> Shihni f.11-13 të dokumentit “Observacion i prokurorit Robert Kote, për të vërtetuar të kundërtën dhe në përgjigje të barrës së provës”.

<sup>41</sup> Shihni f.18, pika 26.10 e vendimit.



*saj, në raport edhe me aktivitetin shumë të gjatë në sistem të këtij prokurori, nuk mund të konsiderohet se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë<sup>42</sup>[...].*

20.1.8 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi ndonëse rasti i referuar në Raportin e DSIK-së, që ngre dyshime për veprime të paligjshme, në dukje nuk përmban elemente që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës, sipas përcaktimeve të nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe në funksion të përcaktimit të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme, në dritën e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, elementet e këtij procedimi, në raport dhe me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

20.1.9 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga përfundimi i Komisionit, i cili nga njëra anë *evidenton shkelje që lidhen me hetim të pathelluar e sipërfaqësor dhe zbatim të gabuar të dispozitës materiale*, nga ana tjetër vlerëson se: (i) *veprimet e subjektit kanë logjikë në mënyrën e interpretimit lidhur me vetë problematikën e konstatuar në ndryshimet, interpretimet e nenit 279 të Kodit Penal; (ii) qëndrimi ka qenë në një linjë me qëndrimin e Policisë Gjyqësore që ka referuar veprën apo se (iii) vlerësimi ka të bëjë me thelbin e zgjidhjes së çështjes dhe bindjen e prokurorit.*

20.1.10 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se: (i) lidhur me nenin 279 të Kodit Penal, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2016, me objekt: papajtueshmërinë me Kushtetutën ... e paragrafit të katërt, të nenit 278, të Kodit Penal, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 29.2.2016, rreth 9 muaj nga data e regjistrimit të këtij procedimi penal, kohë e mjaftueshme për magjistratët për t'u njohur, analizuar dhe përvetësuar njohuritë e nevojshme të rrjedhura prej tij. Po ashtu, ndryshimet e Kodit Penal në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese janë miratuar me ligjin nr.82/2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr.151, datë 11.8.2016, rreth 5 muaj para regjistrimit të procedimit penal objekt vlerësimi, edhe kjo një periudhë kohe e mjaftueshme në aspektin e përvetësimit të njohurive ligjore, për më tepër të një magjistrati prokuror me përvojë; (ii) lidhur me aspektin e qëndrimit në linjë me atë të oficerit të Policisë Gjyqësore sjellim në vëmendje të Kolegjit se oficerët e Policisë Gjyqësore janë në varësi funksionale të prokurorit dhe është ky i fundit që vlerëson për veprimet hetimore që do të ndërmerren. Si rrjedhojë, pavarësisht nga referimi i OPGJ-së në informacionin e dërguar prokurorit, nuk mund të merret e mirëqenë për t'u regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, pasi është diskrecion i prokurorit ngritja e akuzës në varësi të vlerësimeve të tij në lidhje me rrethanat dhe elementet e veprës penale dhe, për pasojë, edhe regjistrimi i njoftimit të veprave penale, sipas kërkesave të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) lidhur me atë arsyetim, që vlerësimi ka të bëjë me thelbin e çështjes, vlerësojmë se aspekti i njohurive ligjore të magjistratit prokuror, vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e tij për të hetuar dhe *cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit*, i cili në rastin objekt vlerësimi, është i papërshtatshëm në raport me elemente të anës objektive të veprës penale, sikurse është sasia e fishekëve e evidentuar në aktet e hetimit, 1.440 fishekë, si dhe gjendja e flagrancës në transportimin e tyre.

---

<sup>42</sup> Shihni f. 24, pika 38 e vendimit.

20.1.11 Komisioneri Publik, referuar *informacionit të organit ligjzbatues*, konstaton se rezultojnë disa rrethana, të cilat të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

### III. C Lidhur me gjetjen në vlerësimin e aftësive profesionale

21. Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 7 denoncime/ankesa nga publiku, 3 prej të cilave prej të njëjtës denoncuese. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime për dy prej tyre dhe, në përfundim, ka arritur në konkluzionin se nuk gjenden shkaqe që mund të merren në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

22. **Denoncim<sup>43</sup> i shtetasit \*\*\*.\*\*\***, i cili pretendon se prokurori Robert Kote, pas arrestimit të \*\*\*.\*\*\*, ka kërkuar si masë sigurie “arrest shtëpie”, pasi u gjykua se \*\*\*.\*\*\* s’kish dorë në ngjarje; mbajti 2 vjet në gjykim çështjen, pa e pyetur asnjëherë \*\*\*.\*\*\*; përfundoi çështjen, pa njoftuar avokatin e tij; ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit \*\*\*.\*\*\*, me akuzën: “Përkrahje e autorit të krimit” dhe gjatë gjykimit ka kërkuar ndryshimin e kualifikimit ligjor, duke e akuzuar për veprën penale “*tentativë vrasje*”. Sipas denoncuesit, prokurori ka ndryshuar qëndrim mbi kualifikimin ligjor të veprës penale për shkak të pamundësisë së familjarëve të shtetasit \*\*\*.\*\*\* për ta paguar. Komisioni ka administruar kopje të dokumentacionit, nga shqyrtimi i të cilit, në mënyrë të përmbledhur, rezultojnë këto rrethana:

22.1 Subjekti i rivlerësimit, prokurori i çështjes, më datë \*\* .11.2017, ka urdhëruar regjistrimin e procedimi penal nr. \*\*\* , në ngarkim të të pandehurve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtje pa leje e armëve luftarake”, dërguar për gjykim në vitin 2019, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe “Armëmbajtje pa leje”, për të pandehurin \*\*\*.\*\*\*, si dhe për veprën penale “Përkrahje e autorit të krimit”, në ngarkim të të pandehurit \*\*\*.\*\*\*.

22.2 Subjekti i rivlerësimit, në kërkesën<sup>44</sup> për dërgimin e çështjes penale në gjyq, lidhur me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, ndër të tjera, ka relatuar se: [...] *Kështu nga aktet hetimore u provua qartazi se i pandehuri \*\*\*.\*\*\* për asnjë moment nuk ka dalë nga mjeti që drejtonte për të shoqëruar ekzekutorin \*\*\*.\*\*\* dhe se nuk u provua që ky i fundit të kishte dijeni qoftë për armën që do të përdorte i pandehuri \*\*\* edhe për veprimet e tjera aktive që do të kryente ky i fundit[...].*

22.3 Me vendimin nr. \*\*\* akti, datë \*\* .6.2020, Gjyqtari i seancës paraprake, ka vendosur: [...]1. *Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë; 2. Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. \*\*\* , të vitit 2017, në ngarkim të të pandehurve \*\*\* \*\*\* \*\*\* , akuzuar për veprën “Vrasje me dashje”, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 76-22, 25 dhe 278/1 të Kodit Penal, dhe në ngarkim të të*

<sup>43</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\* .3.2022.

<sup>44</sup> Në faqen 7 të kërkesës.

*pandehurit \*\*\* \*\*\*, i cili akuzohet për veprën penale “Vrasje me dashje”, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76-22, 25 të Kodit Penal[...].*

22.3.1 Në përmbajtje të vendimit, në pikën 9.1 të tij, arsyetohet se: [...]Po kështu, prokurori, pasi dëgjoi pretendimet përfundimtare lidhur me kërkesën për gjykim nga ana e mbrojtjes, bazuar në nenin 332/d/1 të Kodit të Procedurës Penale, kërkoi ndryshimin e akuzës në seancën paraprake për të pandehurin \*\*\*.\*\*\*, nga: “Përkrahje e autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, në akuzën për kryerjen e veprës penale: “Vrasje me dashje”, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, *parashikuar nga neni 76-22, 25 të Kodit Penal [...].* Në prg. 10 të vendimit, Gjykata arsyeton se, bazuar në nenin 332/d/1 dhe 376 të Kodit të Procedurës Penale, i dha mbrojtësit të të pandehurit 10 ditë kohë për të përgatitur mbrojtjen ndaj akuzës së re. Nga mbrojtja është pretenduar se nuk ka asnjë rrethanë të re, provë të re të cilën prokurori nuk e ka pasur parasysh në fazën e hetimeve paraprake, që do të legjitimonte ndryshimin e akuzës nga prokurori.

22.4 Me vendimin penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2021, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, është vendosur deklarimi fajtor i shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe dënimi me 8 vjet burgim, si dhe deklarimi fajtor i të pandehurit \*\*\*.\*\*\* dhe dënimi me 6 vjet burgim, vendim i ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

22.4.1 Rezulton se i pandehuri \*\*\*.\*\*\* është gjykuar në mungesë në shkallën e parë dhe prokurori ka kërkuar gjatë gjykimit leximin e thënieve të tij.

22.5 Me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2022, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe ridërgimin e çështjes për gjykim nga një trupë tjetër, duke arsyetuar se: *deklarimi i dhënë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\* para Policisë Gjyqësore pa pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit, në praninë e mbrojtësit të caktuar kryesisht, është deklarim që ka prodhuar një provë të papërdorshme në kuptim të nenit 151, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale.*

22.6 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se: [...] *Bazuar në ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale, sipas ligjit nr. 35/2017, veprimtaria e prokurorit përpara dërgimit të çështjes në gjykim kontrollohet nga gjyqtari i seancës paraprake. Bazuar në nenin 332/d, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka të drejtë të ndryshojë akuzën në seancë paraprake, kur fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim. Qëndrimi i prokurorit kontrollohet nga gjyqtari i seancës paraprake, i cili, nëse do të kishte vlerësuar se cilësimi juridik përfundimtar i faktit është i gabuar ose kur akuza është formuluar në mënyrë të qartë, mund ta kishte ftuar të bënte korrigjimet dhe saktësimet e nevojshme. Në rastin konkret, gjyqtari i seancës paraprake, sipas vendimit nr. \*\*\* akti, datë \*\*.6.2020, e ka gjetur drejt ndryshimin e akuzës së prokurorit nga “përkrahje e autorit të krimit” në “vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, e kryer në bashkëpunim dhe e ka dërguar çështjen për gjykim. Më pas, çështja është dërguar për gjykim dhe një trupë gjyqësore, e përbërë nga tre gjyqtarë ka mbështetur akuzën përfundimtare të prokurorit. Në këto kushte, subjekti vlerëson se faktet e parashtruara në këtë denoncim janë tërësisht të gabuara [...].*

22.7 Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *nuk gjeti shkaqe që mund të merren në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar [...].*

22.8 Komisioneri Publik, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2017, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi ndryshimi i cilësimit të veprës penale gjatë gjykimit në seancën paraprake nga subjekti i rivlerësimit, nuk duket se është bërë mbi akte të reja, të ndryshme nga ato të administruara në fashikullin e procedimit penal.

22.9 Komisioneri Publik vlerëson se elementet e këtij procedimi, në raport dhe me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

23. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon shumica e trupës gjyquese, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

24. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

25. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

26. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016;

Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zotit Robert Kote.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**